



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2021

VENDIM
Nr. 512, datë 26.10.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3 e 95 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

V E N D O S I :

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PËRMET

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Alban Veçani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Të pandehur: {...}, etj.; Objekti: “Kërkesë për kalimin në gjykim të procedimit penal nr.14/2 të vitit 2021 dhe kërkesë për pushimin e procedimit penal nr.14/2 të vitit 2021”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Shkëlzen Liçaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Të pandehur: {...}, etj.; Objekti: “Kërkesë për pushimin e procedimit penal nr.14/1 të vitit 2021”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Suela Xhani (relatore), Fatmir Ndreu si dhe gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Arben Dosti, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga nenet 283/2 e 25 dhe 278/6 të Kodit Penal, etj.”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Eglantina Mikani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec; I pandehur: {...}, Shoqëria Tregtare {...}sh.p.k.; Akuza: “Fshehje e të ardhurave ” e parashikuar nga neni 180/1 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Merita Karaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë; me objekt: Kërkesë për gjykim e procedimit penal nr. 72, viti 2020 në ngarkim të pandehurve {...}, {...} akuzuar për veprën penale “Dhunë në familje” parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KURBIN

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Murat Lleshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin; Objekti: “Gjykimin e çështjes penale për të pandehurën {...}, akuzuar për veprën penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, parashikuar nga neni 79/c i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Aurel Arapi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen civile me Paditës: {...} etj; Të paditur: {...}sh.p.k. etj.; Objekti: Detyrim njohje pronar. Sigurim padie për objektin.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË DURRËS

1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Bezart Kaçkini, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, çështjen civile me Paditës: {...}, {...}; Të paditur: {...}, {...}; Objekti: Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të lejes së legalizimit nr. 151380 datë 02.12.2015(016060) për objektin Zk. 8514, nr. Pas 4/99/1, me sip parcele 108 m2 dhe sip për banim 48 m2, në emër të {...} të kontratë kalimi pronësie nr. 2162 rep, nr. 1903/1 kol, datë 19.11.2015, të pikës 432 të VKM nr. 823 datë 07.10.2015 për miratimin e kalimit të pronësisë të sip 108 m2 pas.4/99/1 Zk. 8514 të Ismail Tabaku, etj.

GJYKATA E POSACME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të Kërkesës nr. 1213 prot., datë 05.10.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, {...}, {...}; Akuza: “Nenet 259, 25, 245/1 të Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Toro, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Mbahjtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”; “Plagosja e rëndë me dashje”; “Kanosje”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: Për veprën penale të “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit” dhe “Vjedhje me dhunë”, “Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Irida Kacerja dhe Florjan Kalaja, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 283/a/2 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 124/b, 130/a/4 të Kodit Penal”.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit, çështjen civile me Paditës {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Shfuqizimi i vendimit nr.41, datë 23.01.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për skualifikimin e kandidatës jogjyqtare znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga kandidimi për emërimin si gjyqtare në Gjykatën e Lartë”. Detyrimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vijuar procedurat lidhur me vlerësimin e kandidaturës së saj si gjyqtare në Gjykatën e Lartë”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR